



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 597/1 prot.

Tiranë më 11.3.2022

Lënda: Dhënie mendimi për *“Marrëveshjen për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftën kundër terrorizmit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe”*.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, *“Zyra e Komisionerit”*), ka administruar shkresën tuaj me nr. 9316/36 prot., datë 10.03.2022, protokolluar me tonën me nr. 597 datë 11.03.2022, përmes së cilës kërkohet mendim për *“Marrëveshjen për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftën kundër terrorizmit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe”*.

Sikundër jeni në dijeni, Zyra e Komisionerit ka shprehur qëndrimin institucional mbi marrëveshjen objekt shqyrtimi, përmes shkresës nr. 664/1 prot., datë 14.04.2021, ku ndër të tjera ka rekomanduar plotësimin e njërit prej kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2010 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, (në vijim, *“Ligji”*), me qëllim legjitimimin e procesit të shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve ndërmjet palëve.

Rikujtojmë se, Emiratet e Bashkuara Arabe konsiderohen shtet me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas Vendimit nr. 8, datë 31.10.2016 të Komisionerit *“Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*, për rrjedhojë, me qëllim legjitimimin e procesit të shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve ndërmjet palëve, duhet të plotësohet njëri prej kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 8 të ligjit. Me plotësimin e njërit prej këtyre kriterëve, shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve midis palëve të përcaktuara në Marrëveshje do të konsiderohet konform përcaktimeve të Ligjit.

Me adresimin e sugjerimeve të mësipërme, Marrëveshja vlerësohet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

